

**Partneriteti për një rajon më konkurrues - Partneriteti CORE
me mbështetjen e Shoqërisë Gjermane për Bashkëpunim Ndërkombëtar-GIZ**

PUBLIKON

FTESË PUBLIKE PËR KOMUNAT

për pjesëmarrje

**në programin rajonal të çertifikimit të qyteteve dhe komunave me një mjedis të favorshëm
biznesi në Evropën Juglindore – BFC SEE**

Ftesa për pjesëmarrje **u dedikohet liderëve të zhvillimit ekonomik të rajonit të Evropës Juglindore dhe atyre që kanë vendosur që të bëhen lider** - qyteteve dhe komunave që janë të vendosura që përmes ambientit të biznesit të krijojnë kushte më të mira për nxitjen e investimeve dhe zhvillim më të shpejtë të ekonomisë ekzistuese, dhe kështu të avancojnë cilësinë e jetës së qytetarëve.

Kjo ftesë është ekskluzivisht e hapur për **50 qytete dhe komuna në Evropën Juglindore** të cilët deri më tani nuk kanë marrë pjesë në Programin BFC SEE dhe vizioni për zhvillim i të cilëve bazohet në potencialet lokale autentike. Subvencionimi i çmimit të çertifikimit për tetë (8) komunat/qytetet nga Kosova, të cilat do të aplikojnë për çertifikimin BFC SEE, aplikohet bazuar në kriteret e definuara paraprakisht.

Standardi BFC SEE ofron udhëzime të qarta për ruajtjen e punësimit dhe hapjen e vendeve të punës përmes forcimit të partneritetit me bizneset lokale. Kriteret përcjellin planet zhvillimore dhe mjedisore dhe ndihmojnë që të avancohen kapacitetet organizative, rrisin efikasitetin dhe nivelin e digjitalizimit të shërbimeve komunale. Standardi merr parasysh dhe thekson konkurrencën në pikëpamje të tarifave lokale dhe posaçërisht vlerëson mbështetjen ndaj bizneseve, inovacioneve dhe ekonomisë së gjelbër.

Programi BFC SEE sjell edhe privilegje për të gjithë ata të cilët me sukses e përfundojnë procesin dhe përmbushin kushtet që të bëhen bartës të këtij çmimi prestigjioz:

- **Imazh të administratës lokale të shkathët dhe moderne** në shërbim të qytetarëve dhe ekonomisë
- **Pozicionim në hartën e destinacioneve investive më miqësore** në Evropën Juglindore
- **Njohje** në mesin e vendimmarrësve në vend, sektor privat dhe komunitetin ndërkombëtar
- **Mundësi për pjesëmarrje në projektet zhvillimore, vizitat studimore dhe iniciativat rajonale**
- **Shkëmbim të njohurive** me komunat dhe qytetet më të suksesshme

Më shumë informacion rreth Programit BFC SEE dhe procesit të çertifikimit, kriteret e edicionit IV si dhe për kushtet e pjesëmarrjes mund të gjeni në **kuadër të dokumentacionit të bashkangjitur**. Progresi i procesit do të monitorohet nga mediat e rajonit.



BUSINESS FRIENDLY CERTIFICATION
SOUTH EAST EUROPE

Sesioni informues me temën „*Si të arrijmë certifikatën ndërkombëtare BFC SEE*“ për të gjitha komunat/qytetet e interesuara, do të organizohet më datën 6 prill 2023 prej orës 13:00 në Institutin Riinvest, (Rruga Lidhja e Prizrenit nr.56 në Prishtinë). Qëllimi i këtij sesioni është informimi rreth detajeve dhe kushteve të pjesëmarrjes në Program. Aplikimi për pjesëmarrje në sesionin informues bëhet përmes adresës elektronike riinvest@riinvestinstitute.org, (emri, mbiemri, funksioni, komuna).

